

**VENDIM**  
**Nr.483, datë 17.7.2006**

**MBI LICENCËN E SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV PËRMETI”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

|              |         |
|--------------|---------|
| Halil Lalaj  | Kryetar |
| Sefedin Çela | anëtar  |
| Albert Minga | anëtar  |
| Visar Zhiti  | anëtar  |
| Agim Duro    | anëtar  |

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga z. Gjergji Petro për ndryshimin e të dhënave që kanë ndodhur në kërkesën për marrjen e licencës së “TV Përmeti”.

BAZA LIGJORE: Neni 7, pika 21, neni 22 dhe neni 30 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”,

**VËREN:**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, me vendimin nr.427, datë 21.3.2006, ka licencuar subjektin fizik z.Gjergji Petro për televizionin “TV Përmeti” me numër licence 078/TVL, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve televizive analogjike tokësore, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence. Licenca ka hyrë në fuqi në datën 10.4.2006.

Në datën 11.7.2006 (nr.596 prot.) është paraqitur nga ana e z.Gjergji Petro kërkesa për ndryshimin e të dhënave që kanë ndodhur në kërkesën për marrjen e licencës, lidhur me ndryshimin e formës ligjore të subjektit. Nga ana e këtij personi, është krijuar me vendimin nr.36135, datë 11.7.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shoqëria “TV Përmeti” sh.p.k. me ortak të vetëm dhe administrator z.Gjergji Petro.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është veprimtari radiotelevizive, që përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji, me anë të zërit dhe figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit të destinuar për publikun, nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablllove, përsëritësve, satelitëve dhe çdo mjeti tjetër.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, pasi shqyrtoi kërkesën e z.Gjergji Petro, e vlerëson këtë kërkesë të mbështetur në nenin 30 (Detyrimi për njoftimin e ndryshimeve) të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”.

KKRT vëren se, në mbështetje të nenit 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”: “Licenca e transmetimit është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është dhënë. Në rast se mbajtësi i licencës hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është edhe veprimtaria radiotelevizive e licencuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Subjektit që ka fituar këto të drejta, miratimi i jepet në formën e një licence të re me të njëjtën përmbajtje”.

Duke e vlerësuar kërkesën nga kjo pikëpamje, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit konstaton se kërkesa e z. Gjergji Petro i nënshtrohet tjetërsimit të licencës.

**PËR KËTO ARSYE,**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 22, nenit 30 dhe 33, pika 3, të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. T'i heqë subjektit fizik, z.Gjergji Petro, licencën për TV vendor "Përmeti".
2. Licenca nr.078/TVL bëhet e pavlefshme.
3. T'i japë subjektit juridik, shoqërisë "TV Përmeti" sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Përmetit, licencë me të njëjtën përmbajtje, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve televizive analogjike tokësore për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
4. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
5. Ngarkohet administrata e KKRT-së për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Halil Lalaj**